



WOMEN IN POLITICS

www.votewomeninpolitics.com



'Women In Politics' është një mision për të ndihmuar gratë kandidatë nëpër botë.



i përkushtohet ndihmës së grave për të formuar aftësitë dhe infrastrukturën e duhur për të qenë lidere efektive politike në botë dhe për të frymëzuar gratë e reja të marrin pjesë në politikë.



është një organizatë jo-partiake, trajnimet dhe programet janë FALAS për gratë kandidatë nëpër botë. Organizata mbështetet nga donacione individuale dhe punë vullnetare



synon të ndërtojë një rrjet botëror të grave që konkurojnë për poste politike ose që shërbejnë aktualisht në poste publike, dhe të trajtojë gra të reja për të hyrë në fushën politike.



ndihmon kandidatët në këto mënyra:

- ✓ Ofrimi i trajnimit intensiv dhe mbështetjes politike për të ndihmuar kandidaten të kryejë një fushatë të suksesshme & fituese;
- ✓ Ofrimi i mbështetjes për një fushatë strategjike duke këshilluar dhe duke punuar në veçanti me secilën kandidatë mbi planifikimin, ngritjen e fondeve, paraqitjen e mesazhit, mediat dhe strategjitë politike.

Së bashku ne mund të bëjmë një ndryshim!

Kur ishit fëmijë, kush ëndërronit të bëheshit? Një shkencëtare e cila do të gjente shërimin për kancerin? Një mësuese e cila do të ndihmonte të rinjtë të ndërtonin jetën e tyre? Një zjarrëfikëse e cila do të shpëtonte njerëzit nga ndërtesat e djegura? Unë ëndërrova të bëhem një politikane e cila do të ndërtonte një të ardhme më të mirë për fëmijët tanë.

Duke u rritur, kur shumica e fëmijëve kishin postera të yjeve të rokut mbi muret e tyre, muret e mia ishin mbushur me fotografi të liderëve politik botërorë, që i prisja nga gazetatat. Në atë kohë, shumë pak prej atyre liderëve ishin femra - në vitin 2009 ky është ende një problem

Për të ndjekur ëndërrën time, unë studiova shkenca politike dhe u përfshiva në politikë, duke punuar si një menaxhere fushate, drejtoreshë në nivel fillestar, lobiste si dhe kontribova në ngritjen e fondeve. Pas fitimit të një përvoje të madhe, u ktheva në vendlindjen time në Turqi për të kandiduar për një post politik. U zgjedha nga partia politike të cilën përfaqësoja si nënkryetare e saj. Në moshën 29 vjeçe, isha personi më i ri i zgjedhur ndonjëherë për këtë pozicion në historinë politike të Turqisë..

Kam takuar shumë gra nëpër botë të cilat më kanë kërkuar këshilla mbi menaxhimin e një detyre politike. Atëherë unë vendosa të krijojë një organizatë që të ndihmoj gratë kandidatë nëpër botë.

Kjo është ëndërra ime të shohë më shumë gra në politikë. Besoj se së bashku mund të bëjmë një ndryshim!

Ju lutem mos harroni gjithmonë mund të arrini gjithçka që doni!
Thjeshtë të keni besim në vetëvete, unë besoj tek ju.

Tuğba Kalafatoğlu
Themeluese

Hapi i parë është të besoni në veten tuaj!